

VIZE PER RIHYRJE NE TERRITORIN KOMBETAR

Kjo vizë i lejon hyrjen e sërishme në Itali atij personi i cili jeton rregullisht aty por që momentalisht gjendet në Kosovë dhe:

- ka humbur Dokumentin e Qëndrimit (Permesso di Soggiorno/Carta di Soggiorno) ;
ose

- ka kërkuar lëshimin ose vazhdimin e afatit të Lejes së Qëndrimit dhe akoma nuk i është lëshuar ky dokument (shih saktësimet e mëposhtëme).

Çdo banor i Kosovës i cili kërkon vizë hyrjeje në Itali për Rihyrje në Territorin Kombëtar duhet të paraqitet personalisht pranë Sportelit të vizave të Ambasadës Italiane në Prishtinë në ditën e në orën e caktuar dhe t'i dorëzojë personelit përkatës "Formularin e kërkesës për vizë" me dy fotografi aktuale sipas standardit ICAO, të mbushur në të gjitha pjesët e tij me gërma të mëdha shtypi. Kërkesës për vizë duhet t'i bashkangjiten dokumentet e poshtëshënuar si edhe një fotokopje e qartë e tyre:

1) Pasaportë ose Dokument Udhëtimi me afat vlefshmërie deri në 180 ditë;

2) Fotokopje e qartë e Lejes së Qëndrimit (Permesso di Soggiorno) në Itali ose **e vizës** në bazë të së cilës është kërkuar lëshimi i Lejes së Qëndrimit;

3) Fotokopje e kërkesës (kit postar) për lëshim/vazhdim të afatit të Lejes së Qëndrimit e kërkuar në kohët e përcaktuara nga dispozitat italiane ligjore në fuqi pranë Komisarariatit kompetent të Policisë (Questura);

4) Në rast humbje/vjedhje, denoncimi i humbjes/vjedhjes pranë organeve kompetente të Policisë ku ka ndodhur ngjarja, i përkthyer në gjuhën italiane nga një përkthyes gjyqësor i njohur nga Ambasadë Italiane në Prishtinë;

KUJDES:

Përsa i përket rihyrjes në territorin kombëtar bëhen saktësimet e mëposhtëme:

Duke filluar nga data 11.03.2009, në bazë të Qarkores së Ministrisë së Punëve të Brendshme të Italisë, NR. 400/A/2009/14.201 të datës 11.03.2009 Ju informojmë që kategoritë e mëposhtëme të personave kanë të drejtë të hyjnë në territorin italian PA VIZE:

*****Mbajtës të Lejeve të Qëndrimit të skaduara** (Permesso di Soggiorno) të shoqëruara nga Kërkesa postare për vazhdim (ripërtëritje) të afatit;

Kushtet specifike për rihyrje:

- të jenë të pajisur me pasaportë të vlefshme;
- të kenë Leje-Qëndrimin e skaduar;
- të kenë Kërkesën postare për vazhdim (ripërtëritje) të afatit.

*****Mbajtës të Kërkesës postare për lëshimin e parë të Lejes së Qëndrimit për arsye Bashkimi Familjar, Punë me Kontratë dhe Punë Autonome;**

Kushtet specifike për rihyrje:

- Të jenë të pajisur me pasaportë të vlefshme;

- Të kenë kërkesën postare për lëshimin e parë të Lejes së Qëndrimit për arsye Bashkimi Familjar, Punë me Kontratë dhe Punë Autonome;

KUSHTE TE PERGJITHSHME RIHYRJEJE: Rikthimi në territorin italian **nuk parashikon asnjë udhëtim tranzit** nëpër hapësirën territoriale të Shteteve Schengen; rikthimi, në bazë të çarkores së lartpërmendur, mund të bëhet edhe në pika kufitare kombëtare të ndryshme nga pika kufitare e daljes.

Personat që nuk i përmbushin kushtet e mësipërme duhet të bëjnë kërkesë për vizë Rihyrëse pranë Ambasadës Italiane në Prishtinë.

AMBASADA ITALIANE PRISHTINE